



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr 13033 prot., datë 30.06.2019, në vlerësim të situatës aktuale, të bllokimit të qendrave të votimit si pasojë e situatës problematike, në ushtrim të përgjegjësisë bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe të shqetësimeve të shprehura nga KZAZ nr. 03, ka paraqitur kërkesë që KQZ kryesisht të japë autorizim për ndryshimin e vendndodhjeve të 6 QV-ve në Bashkinë Shkodër.

Prefekti i Qarkut Berat, me shkresën nr 13034 prot., datë 30.06.2019, në vlerësim të situatës aktuale, të bllokimit të qendrave të votimit si pasojë e situatës problematike, në ushtrim të përgjegjësisë bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe të shqetësimeve të shprehura nga KZAZ nr. 64, ka paraqitur kërkesë që KQZ kryesisht të japë autorizim për ndryshimin e vendndodhjeve të 2 QV-ve në Bashkinë Berat.



KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

